

 Autoriteti Portual Durrës <small>DURRËS PORT AUTHORITY</small>	MENAXHIMI		
	POLITIKA LIDHUR ME DISKUTIMET SENSITIVE NË VENDIN E PUNËS NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS		
Kodi Nr.: PO.080	Versioni: 1	Data Efektive: 28.12.2020	Faqe 1 / 1

Në Autoritetin Portual Durrës ne e vlerësojmë diversitetin e punonjësve tanë, si për nga karakteristikat e tyre individuale profesionale ashtu edhe për mendimet dhe bindjet e tyre. Në të njëjtën kohë ne vlerësojmë se ligjërimet sensitive me karakter racor, gjinor, politik, fetar apo të çdo lloji tjetër në vendin e punës janë shpërqëndruese dhe kane ndikime te drejtpërdrejta ose të tërthorta mbi Cilësinë, Sigurinë dhe Produktivitetin e punës në APD.

Nëse punonjësit bisedojnë për çështje sensitive sa me sipër në vendin e punës mund të krijohen situata kur punonjës, kolegë të tjerë të cilët nuk dëshirojnë të marrin pjesë apo të dëgjojnë debate të tilla, të detyrohen të largohen nga vendi i bisedës, i cili me shumë mundësi do të ishte edhe vendi i punës së tyre.

Pikërisht këto situata dhe ngjarje të tjera negative që mund të jenë bashkëshoqëruese të tyre, janë të detyrueshme të shmangen në APD për të ruajtur integritetin dhe mirëqenien në vendin e punës të të gjithë punonjësve tanë. Ato, gjithashtu, mund të ngrenë rrezikun e pretendimeve ligjore ndaj APD ose/dhe punonjësve të tij se diskutime apo ngjarje të tilla mund influencojnë një kah apo një kah tjetër të caktuar politik, fetar apo të çdo lloji tjetër.

Kjo do të binte ndesh totalisht me angazhimin e APD për të trajtuar gjithmonë dhe në çdo rast të gjithë punonjësit, kontraktoret, koncesionarët, bashkepunëtorët e palët e treta vetëm mbi baza tërësisht profesionale, ligjore, etike dhe asnjëherë, e në asnjë rast, bazuar në dallime politike, fetare, racore, gjinor, ato të çdo lloji tjetër.

Gjithsesi, APD nuk dëshiron kurrësi t'u ndalojë punonjësve diskutimet me karakter sensitiv. Në funksion të kësaj APD kërkon që punonjësit të kenë kujdes se ku janë duke zhvilluar këto diskutime dhe të kenë respekt për të gjithë kolegët me të cilët ndajnë vendin e punës apo ambiente të tjera brenda APD. Punonjësit duhet të përmbahen për të mos i zhvilluar këto diskutime në vendin e punës dhe në zona të përbashkëta në APD.

Nëse dëshirohet të diskutohet për çështje sensitive me kolegët, përfshi ato politike apo fetare, APD kërkon që mos ngurrohet të zgjidhen ambiente jashtë APD-se, gjatë kohës së pushimit të punës apo jashtë orarit zyrtar.

Nga të gjithë punonjësit, APD pret në çdo rast dhe kudo ndodhen, që diskutimet për tema të ndryshme sensitive të zhvillohen bazuar në tolerancën e bindjeve ndaj kolegëve dhe në përputhje me të gjitha kërkesat etike, ligjore, traditën dhe kulturën e punës në APD.

PUNOI: <i>Bucurije Gjoni</i>	PRANOI:	MIRATOI: <i>Pirro UNGU</i>
Nënshkrimi: <i>Bucurije Gjoni</i>	Nënshkrimi: <i>Florian Hysaj</i>	Nënshkrimi: <i>Pirro UNGU</i>
Data: <i>23/12/2020</i>	Data: <i>24/12/2020</i>	Data: <i>24/12/2020</i>

 Autoriteti Portual Durrës <small>DURRËS PORT AUTHORITY</small>	MENAXHIMI		
	POLITIKA LIDHUR ME DISKUTIMET SENSITIVE NË VENDIN E PUNËS NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS		
Kodi Nr.: PO.080	Versioni: 1	Data Efektive: 28.12.2020	Faqe 1 / 1

Në Autoritetin Portual Durrës ne e vlerësojmë diversitetin e punonjësve tanë, si për nga karakteristikat e tyre individuale profesionale ashtu edhe për mendimet dhe bindjet e tyre. Në të njëjtën kohë ne vlerësojmë se ligjërimet sensitive me karakter racor, gjinor, politik, fetar apo të çdo lloji tjetër në vendin e punës janë shpërqëndruese dhe kane ndikime te drejtpërdrejta ose të tërthorta mbi Cilësinë, Sigurinë dhe Produktivitetin e punës në APD.

Nëse punonjësit bisedojnë për çështje sensitive sa me sipër në vendin e punës mund të krijohen situata kur punonjës, kolegë të tjerë të cilët nuk dëshirojnë të marrin pjesë apo të dëgjojnë debate të tilla, të detyrohen të largohen nga vendi i bisedës, i cili me shumë mundësi do të ishte edhe vendi i punës së tyre.

Pikërisht këto situata dhe ngjarje të tjera negative që mund të jenë bashkëshoqëruese të tyre, janë të detyrueshme të shmangen në APD për të ruajtur integritetin dhe mirëqenien në vendin e punës të të gjithë punonjësve tanë. Ato, gjithashtu, mund të ngrenë rrezikun e pretendimeve ligjore ndaj APD ose/dhe punonjësve të tij se diskutime apo ngjarje të tilla mund influencojnë një kah apo një kah tjetër të caktuar politik, fetar apo të çdo lloji tjetër.

Kjo do të binte ndesh totalisht me angazhimin e APD për të trajtuar gjithmonë dhe në çdo rast të gjithë punonjësit, kontraktoret, koncesionarët, bashkepunetorët e palët e treta vetëm mbi baza tërësisht profesionale, ligjore, etike dhe asnjëherë, e në asnjë rast, bazuar në dallime politike, fetare, racore, gjinor, ato të çdo lloji tjetër.

Gjithsesi, APD nuk dëshiron kurrsesi t'u ndalojë punonjësve diskutimet me karakter sensitiv. Në funksion të kësaj APD kërkon që punonjësit të kenë kujdes se ku janë duke zhvilluar këto diskutime dhe të kenë respekt për të gjithë kolegët me të cilët ndajnë vendin e punës apo ambiente të tjera brenda APD. Punonjësit duhet të përmbahen për të mos i zhvilluar këto diskutime në vendin e punës dhe në zona të përbashkëta në APD.

Nëse dëshirohet të diskutohet për çështje sensitive me kolegët, përfshi ato politike apo fetare, APD kërkon që mos ngurrohet të zgjidhen ambiente jashtë APD-se, gjatë kohës së pushimit të punës apo jashtë orarit zyrtar.

Nga të gjithë punonjësit, APD pret në çdo rast dhe kudo ndodhen, që diskutimet për tema të ndryshme sensitive të zhvillohen bazuar në tolerancën e bindjeve ndaj kolegëve dhe në përputhje me të gjitha kërkesat etike, ligjore, traditën dhe kulturën e punës në APD.

PUNOI: <i>Bukurie Prani</i>	PRANOI:	MIRATOI: <i>Pirro LENGU</i>
Nënshkrimi: <i>[Signature]</i>	Nënshkrimi: <i>[Signature]</i>	Nënshkrimi: <i>[Signature]</i>
Data: <i>23/12/2020</i>	Data:	Data: <i>24/12/2020</i>